



**VENDIM**

**Nr. 99 Datë 28.07.2015**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË  
“DENAS POWER” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “d” dhe 39 pika 3, dhe nenit 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5, pika 2; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 108, datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21 datë 18.03.2009 te ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.07.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Denas Power” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie;

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “Denas Power” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licensës (neni 9, pika 4./10 gërma “c”). Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti rezulton se shoqëria “Denas Power” sh.p.k. nuk ka realizuar kontrata të mëparshme.

**Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:**

- Sasinë e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar (neni 9, pika 4/10, germa “a”) dhe
- Kapitalin financiar të deklaruar nga Shoqëria për ushtrimin e këtij aktiviteti, (neni 9, pika 4/10 gërma “b”),

do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesëshëm dhe Rinovimit të Licensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t`i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për licensimin shoqërisë “Denas Power” sh.p.k, në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike.
2. Kundërshtimet e palëve të interesuara ndaj këtij aplikimi mund të bëhen brenda 10 ditëve kalendarike nga botimi në gazetë i njoftimit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s mbi fillimin e procedurave të licencimit të këtij subjekti.
3. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE  
**Petrit Ahmeti**  
Në mungesë dhe me porosi  
**Adriatik BEGO**